REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 2, datë 03.12.2020

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË DETAJUAR PËR ZONËN ME RËNDËSI KOMBËTARE DRILON-TUSHEMISHT

Në mbështetje të neneve 7, 9, 18 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, Vendimit Nr. 4, datë 26.07.2018 të KKT-së "Për miratimin e Nismës të Planit të Detajuar të Zonës së Rëndësisë Kombëtare Drilon - Tushemisht", me propozim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e kufirit të miratuar me Vendimin e Këshilli Kombëtar i Territorit Nr. 4, datë 26.07.2018 të KKT-së "Për miratimin e Nismës të Planit të Detajuar të Zonës së Rëndësisë Kombëtare Drilon - Tushemisht", sipas dokumentit të Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare Drilon-Tushemisht, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Miratimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare Drilon-Tushemisht.

3. Dokumenti i plotë i Planit të Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare Drilon-Tushemisht, përmban:

    a) *Planin e Zhvillimit;*
    b) *Rregulloren e Planit;*
    c) *Hartat shoqëruese;*

4. Gjatë hartimit të planeve të tjera sektoriale, planeve të detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjke dhe pilot të zhvillimit, si dhe të tjera të ngjashme me to, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare Drilon-Tushemisht.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit, që hartohen nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit të territorit, me përcaktimet e Planit të Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare Drilon-Tushemisht.

6. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

